

02.03.2022  
Ora 16:05

### RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjeshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

#### PJESËMARRJA :

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, E.Meta, I.Osmanaj**
- **Parti Politike:**      **S’ka**

**Z. I. Celibashi:** Fillojmë seancën publike për të shqyrtuar këto çështje në rend dite: Projektvendimi për shqyrtimin e një kërkesë të Bashkisë Shkodër, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes të disa qendrave të votimit”; dhe projektvendimi që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ për shkelje të Kodit Zgjedhor, sipas kërkesës së Partisë Demokratike, mbi disa aktivitete të Bashkisë Rrogozhinë”.

Këtë pikën e dytë do ta shtyjme, sepse kemi marrë një kërkesë nga Partia Demokratike për ta shqyrtuar në një ditë tjetër dhe meqenëse ata janë kërkuarit, e kemi pranuar kërkesën e tyre për ta shtyrë shqyrtimin e kësaj çështjeje në një ditë tjetër. Në lidhje me kërkesën e Bashkisë Shkodër?

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



**Z. Y. Merkaç:** Po kemi një kërkesë për shtesë në rendin e ditës.

**Z. I. Celibashi:** Çfarë kemi tjetër?

**Z. Y. Merkaç:** Është për shqyrtimin e kërkesës së delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Suedeze për caktimin e vëzhguesve.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, i përfshijmë në rendin e ditës dhe këto dy kërkesa për shqyrtim, për akreditim vëzhguesish. Erion, shkurtimisht në lidhje me këtë kërkesën e parë nga Bashkia Shkodër për zhvendosjen e këtyre qendrave të votimit.

**Z. E. Meta:** Kryetari i Bashkisë Shkodër me shkresat 1180 dhe 1181, datë 24 shkurt, ka paraqitur kërkesa për ndryshimin e 12 qendrave të votimit, të njësive administrative Shalë, Shosh dhe Pult. Përkatësisht, Bashkia Shkodër ka kërkuar që qendrat e votimit 0115, 0116, 0117, 0118, 0119, 0119/1 që ndodhen në Njësinë Administrative Shalë, të transferohen në lagjen "Fermentim", që i përket Njësisë Administrative Rrethina, në një ambient privat. Ka kërkuar që për qendrat e votimit 0132 dhe 0133 që ndodhen në Njësinë Administrative Shosh, të transferohen po në lagjen "Fermentim" të Njësisë Administrative Rrethina, në një ambient privat. Ka kërkuar që qendrat e votimit 0091, 0092, 0093 dhe 0094 në Njësinë Administrative Pult, të transferohen në Njësinë Administrative Rrethina, një ambient privat. Bashkia Shkodër argumenton se asnjë nga qendrat e votimit të sipërpërmendura nuk garantojnë kushte të përshtatshme, të tilla si izolimi, lagështira, nuk disponojnë rrymë elektrike, ujë të pijshëm, etj. Argumentimi i bashkisë për kushtet e vështira të këtyre qendrave të votimit lidhet me kushtet

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 02.03.2022*

atmosferike, zonë me ngricë dhe dëborë, mungesë e energjisë elektrike, ambiente të amortizuara, rrugë me vështirësi në akses, apo pamundësi në disa vende. Në shkresën me numër protokolli 3288, datë 28 shkurt, është parashtruar se numri i zgjedhësve që dimërojnë në këto zona, është jo më shumë se 220 vetë, dhe se në këto zona malore nuk ka asnjë ambient publik dhe është propozuar që qendrat e votimit të vendosen në Njësinë Administrative Rrethina, si njësi më e afërme me këto qendra votimi. Neni 62, pika 4, përcakton kriteret e caktimit të qendrës së votimit, ndërsa neni 93, pika 3 e Kodit Zgjedhor, përcakton kushtet për caktimin e qendrës së qendrës së votimit në ambientet private. Sipas kësaj dispozite KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit, ose në një zonë qendre votimi fqinje.

**Z. I. Celibashi:** Sa është distanca e zhvendosjes, domethënë praktikisht nga këto qendra votimi, atje ku propozohet?

**Z.E. Meta:** Diku tek 50 kilometra.

**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Edhe janë komplet jashtë zonës së qendrës së votimit dhe zonës së qendrës së votimit fqinje.

**Z. E. Meta:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë unë mendoj që nuk jemi në kushtet për ta pranuar këtë kërkesë, qoftë dhe për shkak të distancës, por tashmë të gjitha njoftimet janë bërë në lidhje me vendndodhjen e qendrës së votimit dhe do të shikojmë se si do ta

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



02.03.2022  
Ora 16:10

## RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesës së Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ambasadës Suedeze dhe Ambasadës Britanike për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022".

### PJESËMARRJA :

- KQZ  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z.Illirjan Celibashi  
2.Stafi KQZ:      Y.Merkaj, E.Meta, I.Osmanaj
- Parti Politike:      S'ka

*Z. I. Celibashi:* Pika tjetër!

*Z. Y. Merkaj:* Po kemi një kërkesë për shtesë në rendin e ditës. Është për shqyrtimin e kërkesës së Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Suedeze për caktimin e vëzhguesve.

*Z. I. Celibashi:* Atëherë, në lidhje me akreditimin, me kërkesat për akreditim, miratohet akreditimi i 9 vëzhguesve afatshkurtër dhe 10 përkthyesve të delegacionit të Bashkimit Evropian.

Miratohet akreditimi i 6 vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 përkthyesve të ambasadës suedeze dhe miratohet akreditimi i 9 vëzhguesve afatshkurtër të ambasadës britanike. Tjetër nuk kemi?

Mirë, seanca mbyllet, faleminderit!

Vendim nr. 117

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA

